



## VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

**Data e miratimit:** 23 nëntor 2011

**Numri i lëndës** 2011-18

**Znj. Mykereme Hoxha**

**Kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 23 nëntor 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues  
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare  
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore  
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELI**

1. Ankesa ishte regjistruar më 16 maj 2011.

### **II. THE FACTS**

2. Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesja e ankesës, dhe siç shihen prej dokumenteve në dispozicion të Panelit, mund të përmbledhen si në vijim.

### *Parathënie*

3. Parashtruesja e ankesës ka marrë faturat për tatimin e saj të pronës së paluajtshme për vitin 2008. Ajo nuk është pajtuar me shumën në faturë dhe ishte ankuar në Këshillin për Ankesa të Komunës së Pejës më 7 maj 2008.
4. Pasi asnjë vendim nuk ishte marrë brenda afatit ligjor, ajo ishte ankuar përsëri, siç përcaktohet me ligj, më 3 korrik 2008. Në mungesë të ndonjë vendimi qoftë edhe për ankesën e saj të dytë, parashtruesja e ankesës është ankuar në Gjykatën Supreme të Kosovës sipas Ligjit mbi Konfliktet administrative (Ligji nr. 02/L-202).

### *Procedurat pranë Gjykatës Supreme*

5. Më 14 prill 2009 Gjykata Supreme ka urdhëruar Drejtorin e Buxhetit dhe Financave të Pejës për të marrë një vendim rreth ankesës brenda tetë (8) ditësh nga dita e marrjes së vendimit të Gjykatës Supreme.
6. Gjykata Supreme ka deklaruar se është detyrim i një autoriteti administrativ i instancës së dytë, sipas ligjit, që të vendos rreth një ankese brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh dhe më së voni brenda shtatë (7) ditësh pas kërkesës së dytë të përsëritur. Nëse një vendim iu tillë nuk është kryer në kohë, ankuesi ka të drejtë që të inicioj procedurë ligjore kundër atij autoriteti.
7. Pas vendimit të lartshënuar, në vend të rishikimit të vendimit mbi taksat që ishte subjekt i ankesës, Bordi i Ankesave ka shqyrtuar vendimin e Gjykatës Supreme të datës 14 prill 2009.
8. Parashtruesja e ankesës përsëri ishte ankuar në Gjykatën Supreme, e cila më 16 tetor 2009 kishte shfuqizuar vendimin e Bordit të Ankesave duke deklaruar se "...vendimi ishte i paqartë, i pakuptueshëm, dhe kundërthënës në vete dhe se vendimi tregon se subjekt i shqyrtimit ishte vendimi i mëhershëm nga Gjykata Supreme e jo ankesa e parashtruar nga parashtruesja e ankesës rreth çështjes së tatimit. Një rishikim i një vendimi nga Gjykata Supreme nuk mund të jetë subjekt i shqyrtimi nga organet administrative...".

### *Procedurat pranë Gjykatës së Qarkut të Pejës*

9. Më 30 dhjetor 2009 parashtruesja e ankesës kishte kërkuar që Gjykata e Qarkut të Pejës të urdhëroj ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Supreme, duke kërkuar që në të njëjtën kohë edhe zyrtarë të ndryshëm nga Komuna e Pejës të përjashtohen nga shqyrtimi i ankesës së saj rreth tatimit.
10. Më 9 shkurt 2010 parashtruesja e ankesës kishte pranuar një letër nga Gjykata e Qarkut të Pejës që thoshte se sipas Ligjit mbi Procedurën Administrative një ankese ndaj një akti administrativ dhe një kërkesë për të përjashtuar zyrtarë të caktuar prej shqyrtimit të ndonjë rasti të caktuar vendoset nga organi administrativ apo drejtori i saj e jo nga ndonjë gjykatë. Përveç kësaj, kërkesa e parashtrueses së ankesës që gjykata ta kthej tatimin e saj në statusin e mëparshëm

është çështje që vendoset nga autoritetet administrative. Sidoqoftë, letra ka përmendur se mund të iniciohen procedura gjyqësore në rast të heshtjes nga ana e administratës, siç përcaktohet nga Nenet 130 dhe 131 të Ligjit të përmendur më lart.

11. Parashtruesja e ankesës ka parashtruar ankesën dhe kërkesën e saj tek Gjykatës së Qarkut të Pejës dhe Kryeprokurori i Kosovës. Kërkesa e saj ishte përcjellë tek zyra e prokurorisë në Pejë për të hetuar nëse ka dyshim të bazuar se ishte kryer ndonjë vepër penale, e që duhet të ndiqet sipas detyrës zyrtare.
12. Sipas parashtrueses së ankesës, ajo nuk kishte dashur që të inicioj procedurë penale, mirëpo kërkesat e saj ishin trajtuar si të tilla.

#### *Procedurat në Institucionin e Avokatit të Popullit*

13. Më 4 qershor 2010 parashtruesja e ankesës ka kontaktuar Institucionin e Avokatin e Popullit të Kosovës. Përfundimisht, më 2 nëntor 2010 Avokati i Popullit shpalli ankesën e saj të papranueshme.

#### *Kontaktet me EULEX-in*

14. Në ndërkohë, më 1 shtator 2010 dhe prapë më 21 dhjetor 2010, parashtruesja e ankesës kishte kërkuar që prokurorët e EULEX-it ta marrin përsipër lëndën e saj.
15. Ajo mori përgjigje më 4 dhe 11 janar, dhe më 21 shkurt 2011 ku deklarohet se rasti i saj nuk kishte hyrë në kuadër të kompetencave të Zyrës së Prokurorisë së EULEX-it. Në njërin prej letrave, emri i parashtrueses së ankesës ishte shkruar gabimisht në dokumentin e përkthyer të gjuhës shqipe. Sipas përgjigjes, parashtruesja e ankesës nuk kishte ofruar ndonjë informatë për të treguar se ka pasur bazë sipas Ligjit mbi Kompetencat (Ligji mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Përcaktimin e Lëndëve të gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, nr. 03/L-053) që EULEX-i ta merr përsipër lëndën në fjalë.

### **III. ANKESAT**

16. Parashtruesja e ankesës pretendon se janë shkelur të drejtat e saj dhe se ajo ishte diskriminuar në bazë të gjinisë së saj. Ajo thotë se emri i saj ishte regjistruar gabimisht nga zyrtarët e EULEX-it dhe ajo ankohet se prokurorët e EULEX-it nuk kishin ofruar arsye ligjore për vendimin e tyre që mos ta marrin përsipër ankesën e saj kundër shërbyesve civil dhe punëmarrësve të gjykatës.

### **IV. LIGJI**

17. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të RrP.

18. Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, siç përcaktohet në Rregullës 25, paragrafi 1 i Rregullores së Punës së vet.
19. Sipas Rregullës të përmendur më lart, bazuar në konceptin e llogaridhënies në PLANIN OPERATIV të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat ligjore të gjykatave të Kosovës. Në veçanti, nuk është funksion i tij që të merret me gabimet e faktit apo ligjit që supozohet të jenë kryer nga gjykatat vendore, përveçse apo në atë masë sa ata do të kishin shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut i zbatueshëm në Kosovë.
20. Paneli konstaton se çështja kryesore në lëndën e parashtrueses së ankesës është mos shqyrtimi i kërkesës së saj rreth tatimit dhe mos zbatimi i një vendimi nga Gjykata Supreme. Sidoqoftë, është për keqardhje se praktikisht është dëshmuar që është e pamundur të kryhet hetimi i duhur i një kërkesë rreth çështjes së tatimit, çështjet që kanë të bëjnë me tatimin apo zbatimin e vendimeve të gjykatave të Kosovës nuk bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të Kosovës.
21. Për më tepër, parashtruesja e ankesës ankohet se prokurorët e EULEX-it nuk kanë ofruar baza ligjore për mospranimin e marrjes përsipër të hetimit të ankesës së saj.
22. Paneli më herët ka deklaruar se veprimet e një prokurori të EULEX-it të ndërmarra gjatë shqyrtimit të një rasti janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe prandaj bien në kuadër të mandatit të Panelit përderisa nuk është ngritur ndonjë aktakuzë në një gjykatë kompetente për të shqyrtuar meritat e një rasti (shih *Sadik Thaqi kundër EULEX-it*, 2010-02, paragrafi 64).
23. Megjithatë, në këtë rast, ky nuk është një vendim nga ana e prokurorit të EULEX-it i paraqitur në kontekst të ndonjë hetimi të rastit në fjalë, por është një hedhje poshtë e marrjes përsipër të hetimit.
24. Në lidhje me këtë, Paneli gjen se lënda e parashtruesit të ankesës, lidhur me çështjet e tatimit, qartas nuk bie brenda mandatit të lëndëve që mund të merren përsipër nga prokurorët e EULEX-it nga pikëpamja e Ligjit mbi Kompetencat. Një vendim për këtë qëllim gjithashtu varet nga prokurori i EULEX-it dhe si e tillë nuk mund t'i nënshtrohet hetimit nga ana e Panelit.
25. Në secilin rast, është konstatuar nga prokurori i EULEX-it se asnjë informatë nuk ishte dhënë nga parashtruesja e ankesës për të treguar se ka pasur bazë për EULEX-in që ta merrte lëndën përsipër.
26. Sa i përket gabimit drejtshkrimor të emrit të parashtrueses së ankesës, Paneli konstaton se, së pari, kryeprokurori i EULEX-it kishte kërkuar falje me shkrim për atë gabim të pavend në përkthim. Në

asnjë rast, Paneli nuk mund të kuptoj se si në rrethanat e këtij rasti, një gabim i tillë teknik mund të ngris ndonjë çështje të të drejtave të njeriut.

27. Prandaj, këto çështje në këtë ankesë nuk bien në kuadër të mandatit të Panelit, të përcaktuara në Rregullën 25 të Rregullores së Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.

#### **PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI**

*Konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar ankesën,*

*gjen se ankesa është e pabazuar sipas Nenit 29 (d) të Rregullores së vet të Punës, dhe*

#### **SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Antonio BALSAMO  
Kryesues i Panelit

